

VENDIM
Nr. 108, datë 23.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 848, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA DHE PËRCAKTIMIN
E AUTORITETIT PUBLIK, QË PËRFAQËSON SHTETIN
SI PRONAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE “ALBPETROL” SHA
DHE “ALBGAZ” SHA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 36, pikat 2 e 5; 50, pikat 2 e 4, 57 e 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimin nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë:
“3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “Albgaz” sh.a., është ministria përgjegjëse për infra-strukturën.”.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria “Albgaz” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama